

Në bazë të nenit 100 pika 2 e 3 e Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në mbledhjen e mbajtur më 17.10.2008 nxori këtë

RREGULLORE PER STUDIME THEMELORE – BACHELOR

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohen këto çështje:

- Llojet e studimeve;
- Kushtet e regjistrimit në studime;
- Kohëzgjatja e studimeve;
- Statusi i studentit;
- Të drejtat dhe detyrimet e studentëve;
- Kushti i regjistrimit të vitit;
- Afatet, paraqitja dhe mënyrat e dhënies së provimeve;
- Përfundimi i studimeve dhe punimi i diplomës;
- Përgjegjësia disiplinore;
- Dispozitat kalimtare.

I

Llojet e studimeve

Neni 2

Me qëllim të përgatitjes së kuadrit për veprimtari profesionale dhe kërkimore-shkencore Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, organizon studime të rregullta, me vetfinancim (që nuk financohen nga fondet publike), dhe studime me korrespondencë.

Neni 3

Studimet në Departamentin e Veterinarisë, organizohen vetëm të rregullta dhe kohëzgjatja e tyre është pesë vite.

Neni 4

Studimet themelore-Bachelor organizohen në këto Departamente:

1. Agroekonomi
2. Blegtori
3. Lavërtari-Perimtari
4. Mbrojtje të bimëve,
5. Pemëtari-Vreshtari

Neni 5

Mësimi realizohet në formë të: ligjëratave, seminareve, ushtrimeve teknike, ushtrimeve në laborator, punës praktike në terren, ekskursioneve shkencore-mësimore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmjet punimeve të pavarura të studentëve.

Neni 6

Studimet me korrespondencë mund të vijohën, pa shkëputje dhe me shkëputje nga puna, kombinimi i këtyre mënyrave të studimit, ashtu siç parashihet me Ligjin e Arsimit të Lartë të Kosovës dhe me Statut të Universitetit të Prishtinës.

II

Kushtet e regjistrimit në studime

Neni 7

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë regjistron studentët sipas mundësive dhe kapaciteteve dhe kriterëve teknike e humane që disponon.

Propozimin për regjistrimin e numrit të studentëve të rinj e bën Departamenti dhe e miraton Këshilli i Fakultetit, më pas i dërgohet Senatit të Universitetit të Prishtinës për ratifikim dhe shpallje të konkursit publik, ku parashihet numri i përgjithshëm i studentëve, kushtet e regjistrimit dhe mënyra e zgjedhjes.

Neni 8

Nuk ka kufizim moshe për t'u regjistruar apo për të marrë kualifikim të arsimit të lartë.

Neni 9

Për studimet Themelore–Bachelor, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët i plotësojnë këto kushte:

- të kenë diplomë nga shkollat e mesme përkatëse të Kosovës;
- të kenë diplomë përkatëse në shtetet tjera në kohëzgjatje e saj, është së paku 12 vite e vlerësuar dhe e barasvlerëshme me shkollat e larta të mesme nga MASHT-i, ose
- në raste tjera ku MASHT-i vendos me udhëzim të veçantë.

Neni 10

Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur në konkurs bëhet sipas procedurës kualifikuese. Studenti fiton të drejtën për t'u regjistruar në Fakultet në bazë të poenëve të fituar në procedurën e rangimit sipas kushteve të shpallura në konkurs.

Neni 11

Testi të cilit i nënshtrohen kandidatët për regjistrim në vitin e parë është unik për të gjithë studentët.

Testi për Departamentet Bachelor organizohet në lëndët: Kimi, Biologji dhe Matematikë.

Ndërsa në Departamentin e Mjekësisë Veterinare. Kimi dhe Biologji. Në rastet e veçanta vendoset sipas udhëzimeve nga UP dhe MASHT.

Neni 12

Me rastin e aplikimit kandidatët kanë të drejtë që në paraqitje të shënojnë prioritetet e interesimit të tyre sipas departamenteve ekzistuese. Në këtë rast në qoftë se kandidati nuk arrin të kualifikohet në departamentin e prioritetit të parë, ai ka mundësi të kualifikohet në departamentet e prioritetit të dytë, nëse në të nuk janë plotësuar vendet e planifikuara.

Në rastin e alinesë paraprake, vendi i kandidatëve të kualifikuar të prioritetit të parë nuk mundë të rrezikohet nga kandidatët e prioritetit dytësor, në asnjërin nga departamentet.

Neni 13

Për përgatitjen dhe realizimin e testit kualifikues, Dekani emëron nga radhët e mësimdhënësve, Komisionin për hartimin e testit, i cili përbëhet nga 3 anëtarë (të lëmive përkatëse).

Komisionin për kontrollin e testeve përbëhet prej 7 anëtarëve (nga një për secilin Departament dhe mësimdhënësi i informatikës për llogaritjen e të dhënave në mënyrë elektronike),

Përgjegjësitë dhe obligimet më të hollësishme të Komisioneve i përcakton Dekani me Vendim.

Mandati i këtyre Komisioneve përfundon me përfundimin e procedurës së testimit dhe shpalljes së listës përfundimtare.

Neni 14

Kandidatët kanë të drejtë të ankohen në rezultatet e testit, që nënkupton rivlerësimin e testit, brenda 24 orëve nga momenti i shpalljes së listës preliminare kualifikuese.

Ankesat e kandidatëve i shqyrton Komisioni që realizon testin. Me këtë rast i lejohet kandidatit që rivlerësimi i testit të bëhet në prani të tij.

Neni 15

Regjistrimin e studentëve në semestrin e parë në bazë të konkursit e bënë Administrata Qendrore e Universitetit të Prishtinës, kurse Indeksat i nënshkruan Sekretari i përgjithshëm i Universitetit të Prishtinës.

Neni 16

1. Me rastin e paraqitjes për pranim kandidatët duhet të sjellin këto dokumente origjinale:
 - diplomën origjinale mbi kryerjen e shkollës së mesme (maturës nëse ka pas provim të maturës) ;
 - vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit;
 - dëftesat origjinale të shkollës së mesme;
 - certifikatën e lindjes;

Neni 17

- Kandidatët e pranuar për regjistrim paraqesin këto dokumente:
- fletëregjistrimin e plotësuar i cili mirret me rastin e regjistrimit;
- tri fotografi (formati 4,5 x 6 cm);
- fletëpagesën në lartësi të shumës të caktuar nga Universiteti i Prishtinës.

Neni 18

- 1 Dokumentet e studentit me rastin e regjistrimit mbeten në Shërbimin e studentëve, deri me humbjen e statusit të studentit.
- 2 Shërbimi i studentëve bën regjistrimin e studentëve të rinj në librin amzë, kompjuter dhe formon dosje për secilin student.

Neni 19

Kalimi–transferimi nga ndonjë Fakultet i ngjashëm, nga sistemi katërvjeçar në sistemin Bachelor në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, bëhet me vendim të Dekanit.

Dekani i propozon KF. Formimin e komisionit profesional për shqyrtimin e kërkesave të parashtruara për transferim.

Studenti për kalim–transferim në këtë Fakultet duhet të paraqes kërkesën me shkrim Dekanatit për njohjen e provimeve, duke ia bashkangjitur certifikatën notave, plan programin e studimeve dhe Indeksën.

Komisioni pas shqyrtimit të dokumentacionit, në bazë të nenit 152, të Statutit të UP-së, i propozon Dekanit njohjen e provimeve të cilat janë në harmoni me plan-programin e Departamentit përkatës, kurse Dekani merr vendim mbi kalimin në drejtimin e caktuar.

Periudha e aplikimit për transferim duhet të përputhet me fillimin e vitit akademik në Fakultet.

Regjistrimi i studentit të cilit i pranohet transferimi, bëhet pas dorëzimit të fletëçregjistrimit nga Fakulteti prej të cilit vjen.

III

Kohëzgjatja e studimeve

Neni 20

Studimet themelore Bachelor zgjasin 3 vjet dhe duhet të plotësohen së paku 180 pikë kredi-ECTS-së.

Viti akademik fillon me 1 Tetor dhe zgjat deri më 30 Shtator të vitit të ardhshëm.

Kohëzgjatja e Semestrit dimëror është 1 Tetor deri 15 Janar,

Kohëzgjatja e Semestrit veror është 16 Shkurt deri 31 Maj,

Mësimi në studimet themelore–Bachelor zhvillohet 15 javë për çdo semestër.

Numri i tërësishëm i lëndëve zgjedhore që i ofrohen studentëve për t'i zgjedhur nuk mund të jetë më i madh se dyfishi i lëndëve obliguese.

Neni 21.

Studenti duhet t'i përfundon studimet themelore universitare gjatë periudhës që nuk tejkalon dyfishin e periudhës normale të paraparë për studime sipas statutit të Universitetit të Prishtinës, të cilit i ka regjistruar me përjashtim të rasteve të veçanta për të cilat vendos Këshilli i Fakultetit.

IV

Statusi i studentit

Neni 22

Student, është personi i regjistruar në studime në Universitet, i cili i plotëson detyrimet akademike dhe financiare në pajtim me Ligjin dhe aktet e përgjithshme të Universitetit.

Statusin e studentit e dëshmon me Indeks ose me dokument tjetër të parashikuar me akte të përgjithshme.

Formën dhe përmbajtjen e dokumentit nga aline 2 e këtij neni e përcakton MASHT-i.

Neni 23

Nëse student i për çfarëdo arsyeje e humb Indeks, Shërbimi i studentëve në bazë të shënimeve zyrtare dhe me Vendim të Dekanit, i lëshohet “Indeksi duplikat” i cili i zëvendëson dokumentin e humbur.

Studenti, kërkesës i bashkëngjit dëshminë se dokumenti është shpallur i pavlefshëm, dhe dëftesën mbi pagesën e shpenzimeve për lëshimin e Indeksit duplikat.

Neni 24

Studenti që i ka përmbush të gjitha detyrimet e parapara me plan dhe program mësimor në pajtim me Statutin e Universitetit, fiton të drejtën për t'u regjistruar në vitin vijues të studimeve.

Neni 25

Studenti e humb statusin e tij në raste kur:

- vendos të largohet nga studimet;
- përfundon studimet;
- dështon të regjistrohet në vitin akademik;
- nuk përfundon studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjet së studimeve;
- arrin numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet dhe
- me vendim mbi procedurën disiplinore si dhe raste tjera që parashihen me Ligj. Statut dhe akte tjera normative të Universitetit.

Neni 26

Studenti mund të kërkoj pushim (largim) të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet e dëshmuara si:

- sëmundjes së rëndë;
- kujdesi për fëmijë nën moshën tri vjeçare;
- shtatzënësisë lehonisë, si dhe
- rasteve tjera të parapara me Ligj dhe Statut të Universitetit.

V

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Neni 27

Studentët kanë këto të drejta:

- të marrin pjesë në ligjërata, seminare teorike, ushtrime praktike në laborator dhe teren, ekskursione, diskutime, konsultime profesionale dhe forma tjera të mësimi sipas plan-programeve në fuqi;
- të shfrytëzojnë bibliotekat universitare dhe të fakultetit, pajisjet tjera teknike si internetin, laboratorët, kompjuterët etj;
- të marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit student në organet universitare dhe të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë të caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e besuara në organet universitare;
- të marrin pjesë në aktivitete kulturore e sportive, seminare profesionale, konferenca dhe tubime të studentëve;
- të marrin pjesë në konkurs për çmimin student i dalluar dhe bursist i Universitetit.

Studentët kanë këto obligime

Neni 28

- t'i zbatojnë rregullat e përcaktuar nga Universiteti dhe Fakulteti;
- t'i respektojnë të drejtat e personelit dhe studentëve të tjerë;
- t'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitete akademike;
- të vijojnë mësimin në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve;
- të sillen mirë si në lokalet e Universitetit, Fakultetit ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskredituar Universitetin dhe Fakultetin.

VI

Kushtet e regjistrimit të vitit

Neni 29

Përfundimi me sukses i vitit, në pajtim me programin e studimit është parakusht që studentit të regjistrohet në vitin vijues.

Studenti i cili nuk ka mundur të përfundojë me sukses vitin duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve.

Numri maksimal i viteve të regjistruara është i barabartë me numrin e viteve të rregullta të studimeve.

Neni 30

Senati i Universitetit të Prishtinës me Vendim të veçantë përcakton kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studentëve për çdo vit akademik.

VII

Afatet, paraqitja dhe dhënia e provimeve

Neni 31

Provimet për studimet Bachelor mbahen gjatë afateve të përcaktuara me statut të UP.

Afatet e rregullta të provimeve janë: afati i Janarit, Qershorit dhe Shtatorit.

Oraret e afateve të provimeve, për studentët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë shpallen në fillim të vitit akademik dhe ato përcaktohen në mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se një provim në ditë.

Oraret e provimeve pasi të jenë shpallur, janë detyruese si për stafin akademik ashtu edhe për studentët.

Neni 32

Paraqitja e provimeve do të fillojë jo më herët se 6 ditë para përfundimit të semestrit dhe jo më vonë se 3 ditë para fillimit të afatit të provimeve. Orari i provimit duhet të shpallet jo më vonë se 30 ditë para ditës së provimit.

Neni 33

Nëse studenti nuk mund të hyjë në provim për shkak të një arsyeje madhore, konsiderohet që provimi është anuluar për një kohë të caktuar.

Në të gjitha rastet kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, provimi konsiderohet që ka dështuar.

Dekani i Fakultetit, në bazë të kërkesës së studentit, mund t'i lejojë studentit që të hyjë më herët në provim, po qe se merr pjesë në një program ndërkombëtar për shkëmbim të studimeve ose është duke bërë mësim praktik jashtë vendit gjatë periudhës së caktuar për provim, ose për ndonjë rast specifik.

Neni 34

Provimi i cili përbëhet prej pjesës me shkrim dhe me gojë, mund të mbahet me: shkrim, gojë, test, ushtrime praktike në laborator dhe mjete tjera konkretizuese.

Studenti mund të hyjë në provim me gojë vetëm atëherë kur në vlerësimet paraprake ka marrë notë pozitive.

Suksesi i studentit në provim shprehet me nota prej 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë).

Nota shënohet me numër dhe tekst në fletëparaqitje, procesverbal të provimeve dhe në Indeks të studentit.

Pas përfundimit të provimeve, Fletëparaqitjet dhe Procesverbali i provimit i dorëzohen referentit më së voni tri ditë pas përfundimit të provimit, ato regjistrohen në kompjuter dhe libër amzë.

Provimet janë publike dhe shpallën në tabelën e shpalljeve.

Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë personelit universitar me përjashtim të shefit të Departamentit dhe stafit të Fakultetit si persona të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të kryer kontroll

Neni 35

Studenti që është i pakënaqur me vlerësim, mund të parashtrijë ankesë me shkrim Dekanit të Fakultetit. Ankesa duhet të parashtrijet brenda dy ditëve të punës pasi të jetë shpallur rezultati i provimit.

Dekani pas pranimit të ankesës brenda një dite të punës, formon komisionin e provimit prej tre anëtarësh, por pa pyetësin kundër notës së të cilit është ankuar studenti.

Në rast se përsëritet provimi me gojë apo me shkrim, vlerësimi nga komisioni bëhet në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar Komisioni.

Sipas rregullës, studenti ka të drejtë të hyjë më së shumti tri here në provim të cilin nuk e ka dhënë, herën e katërt, në provim hynë para komisionit të cilin e ka emëruar Dekani.

Nuk mund të parashtrohet ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

Neni 36

Në rast se sërish, studenti regjistron vitin e njëjtë nuk merren parasysh numri i mëparshëm provimeve të dështuara.

Në rast se sërish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai humb statusin e studentit të rregullt për këtë lloj të studimeve.

VIII

Përfundimi i studimeve dhe punimi i diplomës

Neni 37

Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy viteve pasi të jenë përfunduar të gjitha provimet.

Gjatë kësaj kohe studenti duhet të mbrojë punimin e diplomës që t'i përfundoj me sukses studimet.

Studenti që e ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses studimet mund të paraqesë kërkesë Dekanit të Fakultetit për zgjatjen e kësaj periudhe edhe për një vit. Nëse merret vendim pozitiv studenti duhet të paguaj trefishin e tarifës së studimeve për atë periudhë.

Neni 38

Punimi i diplomës për nivelin Bachelor elaborohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushën për të cilën është përcaktuara studenti.

Punimi i diplomës për Bachelor mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre student (grup hulumtues) dhe aty duhet të shënohen qartë kontributi i secilit kandidat.

Kërkesa për elaborimin e punimit të diplomës për Bachelor nga dy ose tre studentë vendoset nga Departamenti.

Neni 39

Punimi i diplomës regjistrohet (paraqitet) në semestrin e fundit të studimeve, sipas planit dhe programit të studimeve.

Punimi i diplomës punohet nga të gjitha lëndët profesionale të departamentitë përkatës të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë.

Neni 40

Për përcaktim të temës së punimit të diplomës studenti paraqitet kërkesë për zyrtarizmin e punimit të temës së diplomës.

Kushtet që duhet t'i plotësoi studenti për të fituar të drejtën e zyrtarizmit të temës së diplomës përcaktohen me planin dhe programin e studimeve.

Kërkesën për zyrtarizmin e punimit të temës së diplomës studenti e merr në shërbimin e studentëve. Me nënshkrimin e tij referenti e vërteton se studenti i ka kryer të gjitha detyrimet dhe i plotëson kushtet për përcaktimit të punimit të diplomës.

Neni 41

Për hartimin e punimit të diplomës është paraparë afati prej së paku 3 e më së shumti 12 muaj nga dita e zyrtarizmit. Në raste të arsyeshme ky afat mund të zgjatet edhe për dy muaj. Kërkesën për zgjatjen e afatit të përfundimit të temës së diplomës me arsyetim përkatës e bën studenti, ndërsa vendimin për aprovim e merr Dekani i Fakultetit.

Neni 42

Në fillim të çdo viti të ri akademik Departamentet e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë i paraqesin, propozimet e temave të punimit të diplomave.

Propozimi i temave të punimit të diplomave bëhet nga secili mësimdhënës në departamentin e caktuar. Mësimdhënësi që ka propozuar temën e punimit të diplomës e udhëheq studentin në rolin e mentorit deri në përfundim të punimit të diplomës.

Brenda një viti akademik, mësimdhënësi nuk mund të ngarkohet me më shumë se 5 punime të diplomës, për raste të jashtëzakonshme (në mungesë të mësimdhënësve në Departament) ky numër mund të shtohet me Vendim të Dekanit.

Neni 43

Punimin e diplomës studenti e dorëzon në pesë ekzemplarë së paku 7 ditë para mbrojtjes, në shërbim të studentëve. Dekani e lejon mbrojtjen, cakton komisionin dhe ditën e mbrojtjes.

Nëse punimi vlerësohet pozitivisht, shkruhet raport në procesverbal të mbrojtjes nga anëtarët e komisionit.

Neni 44

Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe zhvillohet para Komisionit të përbërë nga tre anëtarë (mentorit dhe dy anëtarëve të lëmit të ngushtë me temën) të propozuar nga mentori i punimit të temës, që miratohet nga Dekani i Fakultetit.

Gjatë mbrojtjes me gojë të punimit të diplomës nga ana e kandidatit, komisioni mbanë procesverbalin.

Komisioni e vlerëson punimin e diplomës në pajtim me kriteret e përcaktuara dhe vlerësimin me notë e shënon në Procesverbal dhe Indeks.

Neni 45

Kandidati i cili punimin e diplomës nuk e ka dorëzuar në afatin e zgjatur, punimi i diplomës me shkrim dhe gojë nuk ka qenë e suksesshme i caktohet punimi i ri i diplomës.

Neni 46

Studenti i cili përfundon me sukses studimet Bachelor fiton thirrjen akademike Bachelor i Shkencave Bujqësore për Drejtimin përkatës.

Diplomën për kryerjen e studimeve Bachelor e nënshkruan Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit. Përmbajtjen dhe formën e diplomës e përcakton MASHT-i.

IX

Përgjegjësia disiplinore

Neni 47

Studentët që i shkelin rëndë rregullat, mund të përjashtohen përgjithmonë ose përkohësisht nga Universiteti-Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.

Studentët e dënuar për shkelje kanë të drejtë të ankohen Këshillit të Fakultetit.

Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Senatit të Universitetit, i cili mund të konfirmoj ose të zhvlerësoj vendimin e Këshillit të Fakultetit.

Procedura e marrjes së studentëve në përgjegjësi disiplinore është e përcaktuar me Rregulloren për procedurën disiplinore.

X

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 48

Studentët që nuk kanë mundur t'i përfundojnë studimet gjatë periudhës së caktuar kohore janë të obliguar t'i vazhdojnë studimet me rregullat e reja të studimit që do të bëhen të vlefshme me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Statusi i studentit me studime pa shkëputje nga puna-me korrespondencë dhe ati që nuk financohen nga të fondet publike mund të ndryshoj në të rregullt, nëse studenti jep të gjitha provimet e vitit paraprak në afatin e paraparë dhe arrin notë mesatare jo më pak se 8 (tetë).

Studentët të cilët janë të regjistruar në dy fakultete, bëjnë të gjitha pagesat për secilin fakultet.

Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.

Neni 49

Kjo Rregullore hynë në fuqi nga dita kur Senati i Universitetit të Prishtinës merr vendim përfundimtar për këtë Rregullore të propozuar dhe të aprovuar nga Këshilli i Fakultetit.

Prishtinë, 17.10. 2008

DEKANI I FAKULTETIT

Dr. sc. Shukri Fetahu, Prof. Asc.